

V E N D I M
Nr.17, datë 12.6.1997

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Rustem Gjata, Kryetar i Gjykatës Kushtetuese; Veli Budo; Zija Vuci; Franc Jakova dhe Halil Kopani; Anëtarë të Gjykatës Kushtetuese, më datë 12.6.1997 shqyrtoi në këshill kërkesën e Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, me objekt: Plotësimin e vendimit nr.16, datë 7.6.1997 të Gjykatës Kushtetuese.

Në kërkesë parashtrohet se Gjykata Kushtetuese me vendimin e sipërpërmendur ka vendosur shfuqizimin e shkronjave "a" dhe "b" të nenit 4 të ligjit nr.8218, datë 16.5.1997 "Për disa ndryshime në ligjin nr.7556, datë 4.2.1992 "Për zgjedhjet e Kuvendit Popullor të Republikës së Shqipërisë, ndryshuar me ligjin nr.8143, datë 11. 9.1996", por nuk është përcaktuar mënyra e ndarjes të 40 mandateve shtesë, sipas nenit 11 të ligjit.

Fillimisht Gjykata Kushtetuese e quan të nevojshme të sqarojë se në kompetencën e saj është vetëm shqyrtimi i kushtetutshmërisë së një ligji dhe interpretimi i dispozitave kushtetuese. Kur vendimi i saj është i paqartë, gjithashtu Gjykata bën edhe interpretimin e tij. Si rrjedhojë ajo nuk e ka në kompetencë të vendosë norma të reja ligjore.

Përsa i përket pretendimit të sipërm të Këshillit të Ministrave, gjykata çmon se ai nuk është i bazuar. Në pjesën arsyetuese të vendimit thuhet shprehimisht se : "Nga shfuqizimi i -shkronjave "a" dhe "b" të nenit 11 nuk krijohet boshllëk ligjor, pasi nga përmbajtja e ligjit del qartë se për të nxjerrë vendet e fituara nga ndarja e mandateve shtesë, numri i votave të vlefshme për secilin nga subjektet elektorale që plotësojnë kushtin e paragrafit të parë të këtij neni, pjesëtohet me shumën e votave të vlefshme të tyre dhe thyesa që del shumëzohet me numrin 40. Secili nga këto subjekte merr fillimisht aq vende sa është numri i plotë që del nga veprimet e kryera më sipër. Vendet që ngelen deri në plotësimin e numrit 40 u shpërndahen këtyre subjekteve sipas madhësisë së pjesës dhjetore. Në rast barazimi përdoret shorti ".

Prandaj, nuk ka vend për plotësimin e nenit 11 të ligjit "Për zgjedhjet e Kuvendit Popullor të Republikës së Shqipërisë".

Në këto kushte, Gjykata Kushtetuese vendosi në këshill që çështjen të mos e kalojë për gjykim.

Tiranë, më datë 12. 6.1997
Nr. 21 i regjistrimit themeltar .
Nr. 17 i vendimit.